



UNMIK/REG/2005/49
25 nëntor 2005

RREGULLORE NR. 2005/49

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kreun 8 dhe nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 5 prill 2005 lidhur me Ligjin mbi ujitjen e tokave bujqësore, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 mars 2005,

Duke vënë re se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe veçanërisht sipas neneve 8.1(q) dhe 8.1(r) të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi ujitjen e tokave bujqësore (Ligji nr. 02/L-9) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit me kusht që:

- (a) Ligji të zbatohet në pajtim të plotë me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;

- (b) Në nenin 1 fjalët “duke caktuar” të zëvendësohen me fjalët “duke organizuar”;
- (c) Në nenin 2 fjala “sipas zbatueshmërisë” të vendoset pas fjalës “regjistrim” dhe fjala “shoqatat” të vendoset pas fjalëve “kompanitë për ujitje”;
- (d) Në nenin 3 ku jepet përkufizimi i fjalës “kompani”, fjalët “kompani publike” të zëvendësohet me fjalët “ndërmarrje apo kompani nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM); përkufizimi i fjalës “bartje” të përmirësohet dhe të shënohet fjala “ ‘bartje’ nënkupton bartjen e përgjegjësive të caktuara që kanë të bëjnë me përdorimin e kanaleve sekondare dhe terciare nga kompanitë në shoqata dhe federata”;
- (e) Në nenin 5.1. b fjala “caktoj” të zëvendësohet me fjalën “zhvilloj”; në nenin 5.1. d) fjalët “në bashkëpunim me AKM-në” të shtohen pas fjalëve “jep pëlqimin” dhe fjala “caktuar” të shtohet para fjalës “përgjegjësitë”; Neni 5.1. duhet të fshihet;
- (f) Në fillim të nenit 5.2, fjalët “mbikëqyrja dhe kontrolli i” të zëvendësohet me fjalët “monitorimi dhe udhëzimi”; në nenin 5.2 a) fjala “kompanitë”, që gjendet para fjalës “shoqata” duhet të fshihet dhe në fund të fjalisë duhet të shtohen fjalët “dhe një listë e kompanive”; neni 5.2 b) fjala “udhëzoj” të zëvendësohet me fjalën “drejtoj”; në nenin 5.2 d) fjala “anëtarët” të zëvendësohen me fjalët “anëtarin(ët) e tij”;
- (g) Nenet 5.3 dhe 5.4 duhet të fshihen;
- (h) Në nenin 6.1 fjalët “të regjistruar dhe licencuar” zëvendësohen me fjalët “i autorizuar në mënyrë të rregullt”;
- (i) Neni 6.2 korrigjohet në tërësi si në vijim “Kompanitë operojnë sipas kushteve të cekura në statutet e tyre, në pajtim me delegimet e dhëna sipas ligjit në fuqi. Autorizimi specifikon kushtet zbatuese për dhënien e së drejtës, territorit, kohëzgjatjes, vazhdimin e kohëzgjatjes;
- (j) Në fillim të nenit 6.3 fjalët “që i nënshtrohet autoritetit të AKM-së” duhet të shkruhen pas fjalës “kompetencat” dhe duhet të fshihet fjala “publike”, që gjendet para fjalës “kompanitë”;
- (k) Në rreshtin e parë të nenit 6.4, fjala “ujë” duhet të fshihet dhe fjalët “ - definojnë përgjegjësitë dhe kufijtë mes tyre dhe shoqatave” duhet të shtohen në fund të tekstit;
- (l) Neni 6.5 duhet të fshihet;

- (m) Neni 7.1 duhet të riformulohet si në vijim: “Bartja vendoset nga Bordi mbikëqyrës i kompanisë”;
- (n) Në nenet 7.2 dhe 7.3 duhet të fshihet fjala “të përgjegjësive”;
- (o) Në titullin e kreut V, fjala “UJITJE” duhet të vendoset para fjalëve “PAGESAT PËR UJË”;
- (p) Neni 8.2 duhet të riformulohet si në vijim: “Pronarët e tokave në zonat e ujitjes duhet t’i paguajnë shpenzimet për mirëmbajtje të rrjetit kryesor pa marrë parasysh se a e përdorin apo jo rrjetin për ujitje. Konsumuesit e ujit për ujitje në zonat e mbuluara me rrjet të ujitjes gjithashtu duhet t’i paguajnë shpenzimet e tilla. Pagesat duhet të inkasohen ose nga pronarët apo nga konsumuesit e ujit për ujitje për sa i përket tokave në fjalë”.
- (q) Në nenin 10.2, fjalët “apo konsumon” duhet të shtohen pas fjalëve “ka në pronësi”;
- (r) Në fund të nenit 14 a) dhe 24 a) e c) duhet të shtohen fjalët “brenda afatit të bartjes”;
- (s) Në titullin e kreut X duhet të fshihet fjala “Ujë”;
- (t) Në nenin 30, fjalët “nga ministria” duhet të zëvendësohen me fjalët “në përputhje me ligjin në fuqi”;
- (u) Në fillim të nenit 33.1 fjala “kompanitë” duhet të fshihet dhe fjalët “dhe një listë e kompanive” duhet të shtohen pas fjalës “federatat”;
- (v) Titulli i kreut XVI “DISPOZITAT NDËSHKUESE” duhet të zëvendësohet me “DËNIMET ADMINISTRATIVE” dhe
- (w) Në nenin 36.1, fjala “një gjobë” duhet të zëvendësohet me fjalët “një dënim administrativ (gjobë)”.

Këto ndryshime të shtruara nga pika (b) deri në pikën (w) duhet të pasqyrohen në tekstin përfundimtar të Ligjit.

E nënshkruar më 25 nëntor 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm